



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 17-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 21. 05. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi , anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Nazmi Krasniqi anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
4. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
5. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
6. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
7. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
8. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
9. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
10. Ahmet Maksuti, zyrtar ligjor
11. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
12. Sanije Haziri, përfaqësuese e OSBE-së
13. Venera
14. Përfaqësuesit e KFOR-it Turk,
15. Bekim Krasniqi, "YHR"
16. Alban Nuredini, shef i sek.te informimit
17. Përfaqësuesit e mediave

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 26 anëtarë nga gjithsej 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë, a ka dikush vërejtje apo plotësime.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, Kryesuesja e Kuvendit, vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 votave për një kundër, asnjë apstenim për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë :

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 16-të e KK-së
2. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim të Tokës pasuri shoqërore e KK Lipjan, KBI-së për ndërtimin e Xhamisë në Fshatin Resinoc.
3. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Sallën e Kinofikimit
4. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
5. Propozim Vendim për emërimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Kulturë Rini dhe Sport.

Pas aprovimit të rendit të ditës Kryesuesja e Kuvendit tha se para se të fillojmë me rendin e ditës ju njoftoj se në Komitetin për Çështje Qytetare në vend të Burbuqe Fazliut e cila për shkaqe personale ka kërkuar të tërhiqet nga ky Komision dhe në vend të saj caktohet Arton Retkoceri.

Pastaj pyeti anëtarët se a ka dikush të shtoj diqka para se të kalojmë në rendin e ditës.

Florent Hoxha, unë po e paraqes shqetësimin lidhur me dëmtimin e rrugëve të cilat i kemi ndërtuar më herët nga mbi ngarkesat e kamionëve të cilët bartin zhavor e sidomos nga kamionet e Bektelenkes ,andaj kërkojmë nga Departamenti i Shërbimeve Publike që të merr masa në këtë drejtim.

Shetësimi i dytë është ndërtimi i rrugës 4 korsi dhe është mirrë që po realizohet ky projekt dhe qytetarët kanë kërkesë që në kuadër të mundësive të lihet një pjesë e lirë për qarkullim meqë aty është mbyllë krejtësisht dhe qytetarët nuk mund të hyjnë fare në atë rrugë.

Për Drejtorin e arsimit kam pyetje meqë kombibusi i kontraktuar për bartjen e nxënësve në Gadime përveq nxënësve hyjnë edhe udhëtarë dhe nxënës së klasave të larta dhe ngarkohen 60-70 dhe me këtë rrezikohen nxënësit.

Shqetësim tjetër është ndërtimi pa leje i objekteve a nga Kryetari është thënë se asnjë tullë nuk ka me u qitë pa leje urbane dhe leje ndërtimore a tani ka objekte që po ndërtohen tani pa leje.

Pastaj tha se kemi kërkesen e fshatit Shalë që Qendra e Mjeksisë Familjare të punon qdo ditë dhe të ketë kujdestari.

Enver Kozhani, tha në fshatin Kroishtë është mbyll kanalizimi dhe ujërat e zeza dalin në sipërfaqen tokësore e sidomos te shkolla dhe është rrezik nga shperthimi i ndonjë epidemie.

Vlora Buja, paraqiti shqetësimin e qytetarëve të fshatit Bujan për shkak të mbylljes së kanalizimit si dhe ndërtimin e rrugës e cila ka qenë e planifikuar për vitin 2015 dhe ende nuk ka fillu.

Ramiz Qeriqi, tha se në Qytetin e Lipjanit sidomos në orët e mbrëmjes është vështirë të dilet jashtë në mbrëmje për shkak të kundërmimit të erës nga ferma e pulave, andaj kërkoj që nga institucionet të ndërmerren masa për këtë qëshetje.

Blerim Gashi, shprehi të njejtin shqetësim me parafolësin e gjithashtu parashtroj pyetjen se qka po bëhet me Ndërmarrjen publike të Kosovatransit?

Hajrije Salihu, siqë e dini tani është në prag mbajtja e testit të maturës dhe pritet që ky test të mbahet nga profesorët tanë meqë në vitin e kaluar është mbajtur nga profesorët e jashtëm dhe ka pasur maltretim të nxënësve që ky maltretim ka ndikuar edhe në suksesin e nxënësve, andaj kërkoj nga Drejtori i arsimit në këtë vit të ketë një organizim më të mirë dhe mos të lejon që gjatë mbajtjes së testit të maturës të ketë provokime ndaj nxënësve.

Pyetje tjetër kam lldhur me pagesat e stazhit të punës meqë stazhi i punës nuk iju ka paguar të gjithëve, andaj pyes Drejtorin se në muajt e ardhshëm a do tu paguhen të gjithëve.

Nazmi Krasniqi, është mirë që janë bërë kontinjerët nëntokësorë në Qytetin e Lipjanit por qysh në fillim këta kontinjer janë mbushur dhe më nuk janë zbrazë dhe tani kanë filluar të kundërmojnë. Gjithashtu pyeti se është parapa larja e rrugëve të qytetit se më parë larja e rrugëve është bërë nga njësia e zjarrëfikësve dhe është që së paku të lahen rrugët që janë të frekuentuara më shumë.

Daut Azemi, ngriti dy shqetësime i pari është për qenët endacak që në fillim janë marrë disa masa por tani nuk e dimë se deri ku ka shku kjo punë meqë shihet se nuk ka shumë qenë endacaki. Si pikë e dytë është për Kryetarin meqë qe një vit e gjysëm që e kemi marr pushtetin dhe në fillim e dimë se me sa borxhe e kemi marrë dhe shkelje të procedurave, andaj pyes qfarë veprime janë marrë për shkelje të procedurave.

Petrit Kelmendi, pyeti se investimet kapitale për vitin 2015 a kanë fillu të realizohen sipas dinamikës së parë.

Merita Zeqiri, unë dashta të ngrisë një shqetësim për rrugicat në Lipjan e posaqërisht rrugicën Shaqir Hoxha ka fillu të ndërtohet gjatë fushatës zgjedhore dhe gjer me tani ka mbetur ashtu.

Kërkesë tjetër kam që në Lipjan të ngritet një lapidarë apo pllakë përkujtimore me emëra të Dëshmorëve edhe pse e di që në Kleçkë janë varrezat e Dëshmorëve edhe plaka përkujtimore dhe në të gjitha qytetet e Kosovës i ka ngrit pllakat apo lapidarët kurse në Komunën tonë ende jo, andaj këtë e kërkoj të bëhet në mënyrë që nxënësit dhe të tjerët të bëjnë homazhe para këtij lapidari apo pllakë përkujtimore dhe të dihet të cilët janë Dëshmorët dhe kërkoj që kjo kërkesë e imja mos të mbetet vetëm në letër por të realizohet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, përshëndeti të pranishmit duke shtuar se sot jam këtu për t'ju dhënë përgjigje lidhur me shqetësimet e qytetarëve që i paraqitni ju.

Sa i përket dëmtimit të rrugëve që i paraqiti Florenti e që konsideroj se është plotësisht me vend por kjo është pa fajin tonë meqë Bektelenka e ka marrë lejen e punës nga Ministria. Sa u përket rrugëve lokale ju e dini se kompania Dino e ka dëmtuar rrugën në Gadime dhe pas bisedës me Dinon është ndërtuar rruga alternative dhe më nuk do të dëmtohet rruga e Gadimes e gjithashtu për gurëthyesit në Gadime së shpejti do të bëhet rruga alternative.

Te rruga 4 korsi e cila është vonuar në ndërtim por ka qenë problemi me lapidarin dhe për hjekjen e tij kanë qenë disa procedura dhe tani është zgjidh dhe besoj se së shpejti do të përfundoj ndërtimi i kësaj rruge.

Sa i përket pyetjes për transportin e nxënësve në Gadime, pajtohem se këta kombi bus nuk duhet të përdorën për udhëtarët dhe nxënësit e rritur.

Për objektet pa leje në Lipjan që e përmendi Florenti unë nuk e di se ku është duke ndërtuar pa leje dhe kërkoj që lirisht të thuhet se ku është tu ndërtuar ky objekt dhe unë menjëherë do ta ndaloj ndërtimin e tij.

Sa u përket kanalizimeve është problem i përhershëm dhe kanalizimin duhet ta mirëmbajë kompania e ujësjellësit me që paguhet një taksë për këtë qështje, por dihet se edhe qytetarët duhet ta paguajn taksën.

Për asfaltimin e rrugëve në Bujan që janë të parapara për këtë vit do të asfaltohen por dihet se asfaltohen vetëm rrugët publike e kursesi rrugët privat.

Ferma e pulave është jashtëzakonisht problematike dhe do të interesohem për këtë qështje dhe do të ndërmarrim masa.

Për stacionin e autobusëve kam angazhu dy Nënkryetarët dhe pretendimi jonë që obligimet me ja lënë AKP-së meqë AKP-ja nuk ka borxhe.

Sa i përket testit të maturës kjo qështje më shumë është e qeverisë dhe krejt qka varet prej neve ne do t'i kryejmë punët.

Pagesa e përvojës së punës që kërkoi Hajrija ju njoftoj që është duke u punuar në këtë drejtim dhe së shpejti do të rregullohet kjo qështje dhe askujt nuk do t'i mohohet e drejta ata që i kanë argumentet dhe dokumentacionin në rregull.

Kontinjerët nëntokësor në mungesë të mekanizmit nuk kemi mund me i pastru, por jemi marrë vesh me kompaninë "Pastrimi" që së bashku të blejmë këtë mekanizëm.

Dikush e ngriti qështjen e rrugëve dhe lirisht ju them se do të asfaltohen të gjitha rrugët e parapara por disa rrugë kanë pengesa pronësore.

Të gjitha projektet që janë parapara janë publike por kemi probleme me thesarin se gjerë më tani naj ka marrë 311 mijë euro për obligimet që ka pasur Komuna dhe kjo ka paraqitë pengesë për realizimin e projekteve.

Florent Hoxha, unë falenderoj Kryetarin për përgjigjet e tij dhe sa i përket pyetjes për ndërtimet pa leje që kërkoj të thuhet me emër unë ju njoftoj se kam informata se objekti prapa objektit të Dinon është duke u ndërtu pa leje.

Avdullah Fazliu, unë sot e kam marrë kërkesën e Shalës për mbajtjen e ndërrimit të natës në Shalë por nuk e di se sa do të mund të realizojmë këtë kërkesë për shkak qështjeve buxhetore.

Pasi qështje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 16-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 16-të të Kuvendit?

Linda Shahini, kam vërejtje në ekstrakt që përveq kërkesës që kam pasë për heqjen e objekteve të vjetra të Minjerës e që është konstatuar në ekstrakt kam pasur edhe kërkesën e dytë ku kam propozu që nënave që janë kryefamiljare t'u mundësohet pranimi i fëmijëve të tyre në Çerdhe dhe të lirohen nga pagesa e që ky propozim nuk është përfshi në ekstrakt, kërkoj që të përfshihet.

Vlora Limani-Hajnuni, besoj se sektori për punë të Kuvendit do ta dëgjoj inqizimin e mbledhjes dhe këtë propozim do ta përfshij në ekstrakt.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 për

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 16-të të Kuvendit me vërejtjen e Linda Shahinit.

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim të Tokës pasuri shoqrore e KK Lipjan, KBI-së për ndërtimin e Xhamisë në Fshatin Resinovec.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashanit Drejtor i DKRS-së, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverbali.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin duke shtuar se në KPF është kërku që në mbledhje të Kuvendit të paraqitet edhe harta ortografike në mënyrë që të shihet parcela e tokës që ipet në shfrytëzim.

Labinot Shahini, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe e përkrahim këtë propozim Vendim.

Petrit Kelmendi, na e kemi pasur edhe në KPF këtë propozim Vendim që i është bashkangjit edhe kërkesa e BI dhe shifet mirë se ka sipërfaqe të mjaftueshme, andaj ka qenë mirë që kësaj kërkesë t'i bashkangjitet edhe një kërkesë shtesë për ndonjë aneks të Xhamisë meqë po shifet se në të gjitha fshatrat po ndërtohen objektet për pamje.

Floren Hoxha, këtë propozim Vendim e kemi shqyrtu edhe në KPF dhe kemi kërku që këtij propozim Vendimi t'i bashkangjiten edhe hartat ortografike dhe është mirë që sot u paraqitën dhe na e përkrahim këtë propozim Vendim.

Me që diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja, vuri në votim propozim Vendimin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN, KBI-së (Këshilli i Bashkësisë Islame) PËR NËDRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN RESINOVC

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim toka-Pasuri Shoqërore e KK Lipjan me sipërfaqe prej 600 m², KBI-së (Këshilli i Bashkësisë Islame) në Lipjan.

Neni 2

Sipërfaqja e tokës sipas pikës 1 të këtij vendimi ndahet nga pjesa e ngastrës kadastrale P-71409073-01023-0 në vendin e quajtur "Raishte groblje" me sipërfaqe prej 3301m², e evidentuar në Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr.14-7339 ZK Resinovc-Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 3

Sipërfaqja e tokës si në nenin 1 të këtij Vendimi ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Resinovc, për ushtrimin e rregulltë të aktiviteteve fetare.

Neni 4

Me këtë Vendim obligohet DGJK-Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit të shfrytëzimit të pjesës së palujtshmërisë nga KBI (Këshilli i Bashkësisë Islame) në Lipjan siq përcaktohet në nenin 2 të këtij propozim-vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik dhe DGJK-Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë : Vendimi

III

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Sallën e Kinofikimit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, tha se KPF-ja ka shqyrtu këtë propozim Vendim dhe ka dhënë rekomandimin që në Vendim të vëhet emërtimi Shtëpia e Kulturës "Tahir Sinani" sipas Vendimit të Kuvendit mbi Themelimin e Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" në Lipjan. Në vazhdim i dha fjalën Drejtorit të DKRS-së Basri Hashanit i cili tha se Vendimi për themelimin e qendrës kulturore "Tahir Sinani" në Lipjan është marrë nga Kuvendi në 2010 dhe atëherë nuk kam qenë Drejtor dhe procedurat për këtë Vendim nuk janë zbatuar. Në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimit i cili sajón pjesën përbërëse të këtij procesverbal.

Agron Hajdini, para neve kemi një Vendim për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të sallës së kinofikimit dhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim dhe besoj se është interes edhe i Komuës ku do të ketë të hyra nga ky Vendim e gjithashtu kërkoj që në të ardhmen të aktivizohet edhe salla në Magurë.

Petrit Kelmendi, u përmendën të hyrat dhe konsideroj se duhet të dihen se sa janë ato të hyra dhe unë mendoj se kishte qenë më mirë që kjo sallë të menagjohet nga vetë Komuna meqë siqë e dimë me buxhetin për vitin 2015 kemi parapa mjete për rregullimin e kësaj qendre.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, na nuk mund ta funksionalizojmë këtë qendër se nuk keni mund as ju e as na tani e siqë e dini edhe ju është duke u ndërtuar edhe Biblioteka dhe punëtorët që janë në qendër do të vijë në Bibliotekën e re dhe ai objekt do të mbetet i pa shfrytëzuar dhe do të shkatërrohet dhe populli thotë se një shtëpi që nuk ka njerëz ajo shkatërrohet. Pastaj njoftoi se me mjetet që kemi parapa për këtë qendër ka filluar renovimi i saj.

Florent Hoxha, edhe ne si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim e gjithashtu edhe në KPF dhe kemi dhënë vërejtjet tona. Në vazhdim tha se me

Rregulloren për taksa komunale është parapa që shfrytëzimi i sallës për një orë kushton 50 euro e tani ky Vendim është në kundërshtim me Rregulloren dhe ne jemi kundër aprovimit. Në Vendimin që është propozu nuk është përfshi fare emërtimi Qendra Kulturore “Tahir Sinani” dhe pas vërejtjes tonë është zbulu se Vendimi i Kuvendit për emërtimin e Qendrës Kulturore “Tahir Sinani” nuk është azhuru dhe nuk janë zbatu procedurat.

Blerim Gashi, parimisht e përkrahu këtë propozim Vendim meqë po hapet rruga e investimeve publiko-private dhe me këtë Vendim është një konkurrencë e lirë dhe na nuk e dimë se kush konkuron dhe paragjykimi se kjo sallë i ipet kompanisë së caktuar nuk qëndron. Në vazhdim pyeti se në konkurs a kemi të drejtë me i qitë kriteret minimale.

Ukë Kryeziu, propozoj që ky propozim Vendim të shtyhet për shqyrtim të më vonshëm dhe kërkoj që së pari të kryhen procedurat e Vendimit të Kuvendit për emërtimin e Qendrës Kulturore “Tahir Sinani” dhe të emërohet Drejtori i Qendrës Kulturore “Tahir Sinani”. Unë nuk mendoj se duhet të shkohet në privatizim të kësaj qendre apo dhënien në shfrytëzim.

Imri Ahmeti, së pari dyshoj se dikush e merr këtë sallë. Nuk është problem vetëm menagjimi por dine se shumica e komunave këto objekte i kanë dhënë në menagjim kompanive private.

Rregullorja që u përmend do ta zbatojmë dhe Komuna do t'i shfrytëzon sallat sa herë që ka nevojë.

Vlora Limani-Hajnuni, u përmend dhënia në shfrytëzim e objektit të kulturës por nuk ipet në shrytëzim tërë objekti por vetëm salla e kinofikimit.

Ramiz Qeriqi, e përkrahi këtë propozim Vendim por nuk e di si mund të funksionoj kjo sallë kur nuk ka zyre për punë e gjithashtu nëse kjo sallë ipet në shfrytëzim është mirë që aktivitetet komunale, shkollat dhe organizatat e dalura nga lufta të lirohen nga pagesa.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim Propozim Vendim me ndryshimin që në nenin 1 të thuhet salla e kinofikimit e cila gjendet në kuadër të qendrës kulturore “Tahir Sinani” në Lipjan ish ndërtesa e shtëpisë së kulturës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 12 vota për, 9 kundër dhe 4 apstenime, miratoi këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS – SALLËN E KINOFIKIMIT

Neni 1

Me këtë Vendim, ipet në shfrytëzim afatshkurtër Salla e Kinofikimit e cila gjendet në kuadër të Qendrës Kulturore “Tahir Sinani” në Lipjan ish ndërtesa e Shtëpisë së Kulturës , me sipërfaqe prej 400m2, ngastra kadastrale nr P-71409044-01637-0 ZK Lipjan, pronë shoqërore e KK.Lipjan.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi është aktivizimi i kinemasë dhe teatrit dhe do të kenë të drejtë të aplikojnë, nëpërmjet procedurës së ankandit publik të gjitha subjektet e interesuara, që janë të regjistruara për zhvillimin e kësaj lloj veprimtarie.

Neni 3

Në pajtim me nenin 1 të këtij Vendimi prona e cekur ipet në shfrytëzim në afat prej 5 (pesë) viteve, me kushte të veqanta të përcaktuara me Njoftimin për pjesëmarrje në ankand publik sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara me Rregulloren QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Procedurën e ankandit publik e udhëheq Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.404-13205 të datës 31.03.2014, në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës – Sektori për çështje pronësore – juridike, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashanit Drejtor për KRS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, me Vendim të Kuvendit që e kemi marrë më herët kemi obligim për pagesën e shpenzimeve të varrimit dhe në bazë të fakturave që kanë arritë është propozu ky Vendim dhe na si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim.

Xhevat Olluri, është mirë që Kuvendi të autorizon Kryetarin për marrjen e këtyre obligimeve deri në nxjerrjen e Rregullores për varreza.

Valbona Shillova, ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë Vendim por kërkoj që të nxirret një Rregullore dhe të caktohet një vij buxhetore për këtë qështje.

Meqë diskutimet tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota pë,r miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej 5280 €, (pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë) euro për subvencionim të shpenzimeve të varrimeve, për 48 raste të vdekjes të cilat kanë ndodhur prej datës 17.02.2015 deri më 14.04.2015 nga 110 Euro për secilin rast $48 \times 110 = 5280$.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të subvencionohet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2015.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim Vendim për emërimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Kulturë Rini dhe Sport.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Linda Shahinit Kryetare e Panelit përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për Kulturë, Rini dhe Sport e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit se Komisioni dy herë ka shpallur konkursin për shkak se herën e parë nuk kanë konkuru mjaft kandidat.

Në konkursin e dytë janë lajmërua 5 kandidat si vijon:

1. Imer Hyseni
2. Ylber Lekaj
3. Shqipërim Gashi
4. Ylber Statovci dhe
5. Rexhep Gërbeshi

Në vazhdim i propozoj Kuvendi që këta kandidat t'i emëron për anëtarë të Komitetit Konsultativ për Kulturë, Rini dhe Sport.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Blerim Gashi, na po formojmë Komitete a në anën tjetër nuk po paguhen dhe konsideroj që nëse nuk paguhen edhe funksionimi i tyre është në pikëpyetje.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim e gjithashtu tha se kur është formu komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve ne e kemi kundërshtu se për disa është thënë se janë nga shoqëria civile dhe nuk kanë qenë nga shoqëria civile por nga militantë të partisë në pushtet dhe e kemi kundërshtu.

Vlora Limani-Hajnuni, na mjetet financiare i kemi planifiku për paga dhe medijtje por janë disa pengesa procedurale për pagesa dhe nëse nuk arrijnë t'i paguajnë mjetet kanë me tepu

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstati se me 18 për 11 kundër miratoi këtë:

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 12,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni